




MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MIRËQENIES SOCIALE
SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMËS

Nr.Prot _____

Data _____



PROJEKT BUXHETI SUT

VITI 2026

- **BAZA LIGJORE**

Ligji nr 87/2025 date 12.12.2025 të miratuar: Për buxhetin e vitit 2026.

Në zbatim të Udhëzimit nr 2 datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit vjetor 2026”.

Ligji nr. 9936/2008 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Udhëzimi i MFE nr 7 datë 28.02.2018 “Per procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”

Udhëzimi i MF me nr.7, datë 28.02. 2025 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028

Udhëzimi nr 9 dt 20.03.2018 te MFE “ Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ”

VKM me nr. 36 datë 21.01.2026 “Për Financimin e Shërbimeve Shëndetësore Spitalore nga skema e Detyrueshme e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për Vitin 2026”.

VKM nr. 1001, datë 2.12.2015 “Për integrimin e Spitalit Universitar të Traumës dhe Spitalit Ushtarak të Forcave të Armatosura në një strukturë të bashkuar” i ndryshuar me VKM 460 date 26.07.2023 Spitali Universitar i Traumës është institucion shëndetësor publik në varësi administrative të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

VKM nr.424 datë 26.06.2024 ”Për miratimin e struktures së pagave, niveleve te pagave e shtesave mbi pagë, kompesimeve dhe trajtimeve të tjera financiare të punonjesve të sistemit shëndetësor, në institucionet shëndetësore, në sistemin e ministrisë përgjegjese për shëndetësinë, në strukturat shëndetësore të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë , të drejtorisë së përgjithshme të burgjeve, dhe të drejtorisë së përgjithshme të policisë së shtetit.

VKM nr.422 datë 26.06.2024 “Për një ndryshime në vendimin Nr.326 datë 31.05.2023, te Këshillit të Ministrave, ”Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike te ndryshuar

Kontrata nr.27/9 datë 07.01.2026 me objekt “Kontratë për Financimin e Shërbimeve Shëndetësore Spitalore për vitin 2026 ndërmjet Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Spitalit Universitar të Traumës”.

Shkresa e FSDKSH nr.2810 Prot date. 07.07.2025 për ”Procedurat e hartimit te Projekt Buxhetit për vitin 2026-2028.

Vendim nr 119 date 26.02.2025 per ”Miratimin e Tavanëve përgatitore te Programit Buxhetor Afatmesem 2026-2028.

• Relacion Projekt Buxheti SUT viti 2026

Spitali Universitar i Traumës ka varësi buxhetore dhe administrative nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Fondet e akorduara për SUT në të dyja programet buxhetore “Mbështetja për Shëndetësinë” e Ministrisë së Mbrojtjes dhe “Shërbimet e kujdesit dytësor” e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kanë si qëllim ofrimin e një shërbimi sa më të specializuar mjekësor dhe spitalor në nivel universitar, në trajtimin në rang kombëtar të politraumave që përbën angazhimin kryesor të këtyre programeve.

Treguesit e performancës për këtë qëllim janë:

- Numri i Urgjencave të Shërbimit të Kirurgjisë dhe Terapisë
- Numri i Pacienteve të shtruar, të planifikuar dhe urgjente në SUT
- Numri i Operacioneve të sallës operatore të urgjencës
- Përqindja e Mortalitetit.

Qëllimi i këtyre programeve shprehet me dy objektiva themelore të SUT.

Objektivi I :

Pritja dhe trajtimi i pacientëve të politraumatizuar në kohë reale pranë Urgjencës së SUT
Treguesi i performancës për këtë objektivi:

- Nr. i Shtrimeve nga Urgjenca
- Nr i Urgjencave të shërbimit të Kirurgjisë
- Nr i operacioneve në Sallat Operatore të Urgjencës
- Nr i manipulimeve të ndryshme kirurgjikale
- Përqindja e Mortalitetit në Urgjencë

Objektivi II :

Trajtimi shëndetësor dhe spitalor i pacienteve sipas specialiteteve mjekësore pranë SUT
Treguesi i performancës për këtë objektivi:

- Nr i shtrimeve reanimatore.
- Nr i operacioneve sipas specialiteteve mjekësore në bllokun operator të SUT.
- Nr. i Ekzaminimeve Imazherike.
- Nr. i Ekzaminimeve Laboratorike.
- Dite Qëndrimi në spital.
- Koficienti i shfrytëzimit të shtratit, etj

Bazuar në kërkesat buxhetore që Spitali Universitari Traumës ka parashtruar në PBA 2026-2028 Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka hartuar Projekt Buxhetin e vitit 2026 në të dyja kodet e Insitucionit .

Artikulli buxhetor 600 (Paga dhe Shpërblime). Ky fond është rishikuar pas perfundimit të ndryshimeve organike të strukturës së SUT për vitin 2024, si dhe ndryshimit të VKM-se së pagave: VKM Nr.424 datë 26.06.2024 dhe VKM Nr.422 datë 26.06.2024. Si rrjedhojë dhe artikulli buxhetor 601 (sigurime shoqërore dhe shëndetësore) do të ketë ndryshime në rritje.

Realizimi për vitin 2025 - Plan viti 2026:

	Realizim MM 2025	Plan MM 2026	Realizim MSHMS 2025	Plan MSHMS 2026
Art 600	695,375,308	715,336,000	189,940,986	203,000,000
Art 601	114,015,591	119,300,000	29,942,293	33,900,000

Artikulli buxhetor 602 (Mallra dhe Shërbime)

Kërkesat buxhetore për vitet 2026–2028, art 602 (Shpenzime Operative) paraqiten me rritje. Kjo është ndiktuar nga ngarkesa e shtuar funksionale e Spitalit Universitar të Traumës, si institucion terciar përgjegjës për menaxhimin e traumave në nivel kombëtar. Në këtë kuadër, rritja e numrit të aksidenteve, fatkeqësive dhe urgjencave traumatike në shkallë vendi ka sjellë një rritje të vazhdueshme të kërkesës për shërbime mjekësore specializuese, duke ndikuar drejtpërdrejt në nevojën për rritje të fondeve në të gjithë artikujt .

Nëzërat e parashikuara në këtë artikull si: Medikamente dhe materiale mjekësore, uniforma për personelin civil dhe ushtarak, lavanderi, ruajtja dhe siguria, pastrimi dhe gjelbërimi, evadimi i mbeturinave, shërbime transporti, shpenzime udhëtimi, shërbime për mirëmbajtjen të zakonshme, etj, janë llogaritur me saktësi bazuar në marrëveshjet kuadër aktuale dhe parashikimeve të bëra nga SUT, si dhe rritja e buxhetimit të tyre është bërë brenda parashikimeve të Ministrisë së Financave

Artikulli buxhetor 606 (Transferta për buxhetet familjare dhe individët), është kërkuar i njëjti fond me vitin e kaluar , i cili rishikohet gjatë vitit buxhetor në varësi të personelit të dalë në pension apo fatkeqësive familjare të punonjësve.

Artikulli buxhetor 231 (investime):

Spitali Universitar I Traumës është në proces të realizimit të projektit "Rikonstruksioni i Godinës së Korpusit Qendror dhe Sistemimi i Ambienteve të Jashtme të SUT.

- Projekti i "Rikonstruksionit të Godinës së Korpusit Qendror dhe Sistemimi i Ambienteve të Jashtme të SUT" është një iniciativë afatgjatë, e parashikuar të realizohet gjatë periudhës 2024 deri në 2028.

Ky projekt synon përmirësimin dhe zgjerimin e kapaciteteve infrastrukturore të SUT, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës për stafin mjekësor duke siguruar ambiente bashkëkohore dhe funksionale , si dhe përmirësimin e kushteve të akomodimit dhe trajtimit për pacientët, përtej standardeve aktuale Ky projekt përfshin gjashtë lote kryesore:

Loti 1: Ortopedi

Loti 2: Reanimacioni dhe Kirurgjia

Loti 3: Urgjenca

Loti 4: Facilitetet

Loti 5: Neurokirurgjia dhe ORL

Loti 6: Sistemimi i jashtëm

Aktualisht po punohet për realizimin e Loti 3 (Urgjenca) dhe Loti 6 (Sistem i jashtëm) për të cilat SUT ka lidhur kontratat e shërbimit.

- Projekti – “Blerje pajisjesh dhe aparaturash mjekësore

Projekti “Blerje pajisjesh dhe aparaturash mjekësore” ka filluar që në vitin 2020 dhe parashikohet të zgjasë përtej vitit 2028, për shkak të nevojave të vazhdueshme të SUT për pajisje moderne dhe të teknologjisë së avancuar .

Ky projekt është një hap i rëndësishëm për të siguruar që Spitali Universitar I Traumes të përmbushë kërkesat e teknologjisë mjekësore, të jetë në përputhje me zhvillimet më të fundit teknologjike, duke ofruar shërbime të avancuara dhe të sigurta për pacientët. Gjithashtu nje pjesë e pajisjeve dhe aparaturave mjekësore aktuale kërkojnë zëvendësim për shkak të përdorimit të gjatë dhe të normës së lartë të amortizimit ne vite.

Projekti – “Blerje Mobiljesh” parashikon pajisjen e Korpusit Qendror të SUT me mobilje të reja dhe funksionale, menjëherë pas përfundimit të procesit të rikonstruksionit.

Bashkëlidhur **Projekt buxhetin e SUT për vitin 2026** me detajimin e fondeve për të gjithë artikujt buxhetor në të dy kodet e Institucionit:

SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMES

<i>Artikulli</i>	<i>Emertimi</i>	MINISTRIA E MBROJTJES	MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MIREQENIES SOCIALE
		<i>Kodi I Institucionit</i>	
		1017138	1013104
1	2	3	4
600	Paga, Shperblime e Shpenzime te tjera personeli	715,336,000	196,800,000
601	Kontrib. e Sigurimeve Shoqerore	119,300,000	31,000,000
602	Mallra dhe Sherbime	798,164,000	410,000,000
606	Transferta per Buxhetet Familjare dhe Individet	2,000,000	-
231	Shpenzime Kapitale te Patrupezu-ara	500,000,000	-
	TOTALI BUXHETI 2026	2,134,800,000	637,800,000
6020	Materale zyre dhe te pergjithshme	0	9,200,000
6020100	Kancelari		2,200,000
6020400	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale		7,000,000
6021	Materiale dhe Sherbime speciale	564,764,000	214,300,000
6021001	UNIFORMA DHE TE TJERA VESHJE SPECIALE LAVANTERI	114,000,000	
6021003	ILACE DHE MATERIALE MJEKESORE,OKSIGJENI,PROTOKSID	351,764,000	210,800,000
6021004	FURNIZIME DHE SHERBIME ME USHQIM PER MENCAT	48,000,000	
6021010	SHPENZIME PER PRODHIM DOKUMENTACIONI SPECIFIK(Libra kartela regjistra)		3,500,000
6021012	Tarifa OBP	45,000,000	
602.1099/1	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	6,000,000	
6022	Sherbime nga te trete	119,200,000	141,700,000
6022001	ELEKTRICITET	10,000,000	25,000,000
6022002	UJE	10,000,000	15,000,000
602.2003	Sherbime telefonike		700,000
602.2004	Sherbime postare		
6022008	SHERBIME TE SIGURIMIT DHE RUAJTJES	49,000,000	-

6022009	SHERBIME TE PASTRIMIT DHE GJELBERIMIT	45,000,000	
6022011	KOSTO E TRAINIMIT DHE SEMINAREVE	400,000	
6022099	SHERBIME TE TJERA EVADIM MBETURINA	4,800,000	41,000,000
6022099/1	Sherbime laboratorike PPP		60,000,000
6023	Shpenzime Transporti	0	8,000,000
6023100	Karburant dhe vaj	-	7,000,000
6023300	Shpenzimet e siguracionit të mjeteve të transportit	-	1,000,000
6024	Shpenzime Udhetimi	600,000	0
6024100	UDHETIM I BRENDSEHEM	500,000	
6024200	UDHETIM JASHTË SHETIT	100,000	
6025	Mirembajtje të Zakonshme	108,500,000	35,500,000
6025300	SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN e objekteve ndertimore	4,500,000	7,000,000
6025500	SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E APARATEVE, PAJISJEVE TEKNIKE DHE VEGLAVE TE PUNES	50,000,000	20,000,000
6025600	SHPENZIMEVE PER MIREMBAJTJEN E MJETEVE TE TRANSPORTIT		8,500,000
6025800	SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E PAJISJEVE TE ZYRAVE	54,000,000	0
6026	SHPENZIME PER QIRAMARRJE	200,000	0
6026100	SHPENZIME PER QIRAMARRJE AMBJENTESH	200,000	
6027	Detyrime dhe kompensime legale	2,000,000	0
6027500	SHPENZIME PER EKZEKUTIM TE DETYRIMEVE KONTRAKTUALE TE PAPAGUARA	2,000,000	
6029	Shpenzime të tjera operative	2,900,000	1,300,000
6029003	SHPENZIME GJYQESORE	400,000	-
6029004	SHPENZIME PER SIGURIMIN E NDERTESAVE DHE TE TJERA KOSTO SIGURIMI TE NGJASHME	-	1,000,000
6029008	SHPENZIME PER TATIME & TAKSA TE PAGUARA NGA INSTITUCIONI	1,000,000	300,000
6029099	SHPENZIME PER TE TJERA MATERIALE DHE SHERBIME OPERATIVE	1,500,000	
	Totali nga buxheti 602	798,164,000	410,000,000

**DREJTOR I PERGJITHSHEM
EDLIRA BODE**

Punoi : E.BREGU

Miratoi : F.SHEHAJ

